



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KESHILLI I BASHKISE  
KAVAJË**

Adresa: Bulevardi "Josif Budo"

Lgj. Nr.1 Kavajë

Kavajë, më 04/03/2016

**VENDIM**  
**Nr. 12 DATË 04.03.2016**

Ne mbledhjen e rradhes, Keshilli i Bashkise Kavaje mori ne shqyrtim Projekt-Vendimin e paraqitur nga Drejtoria e Kultures dhe Sportit me propozim te Kryetarit te Bashkise, mbeshtetur ne nenin 54, germa "m" e ligjit nr. Nr. 139/2015, date 17.12.2015 " Per veteqeverisjen vendore" dhe ligjin Nr. 112/2013 " Per Dekoratat, Titujt e Nderit, Medaljet dhe Titujt Vendore te Nderit ne Republiken e Shqiperise" dhe,

**VENDOSI:**

1. Dhënien e titullit "**Mirënjohje Qyteti**" Z. **Pëllumb Lusha** me motivacionin "Për kontributin e shquar në fushën e arsimit dhe mësuesisë, duke nxjerrë breza të tërë nxënësish dhe duke përcuar kulturë në qytetin e Kavajës.
2. Dhënien e titullit "**Mirënjohje Qyteti**" Z. **Halil Kariqi (post mortem)** me motivacionin "Për kontributin e shquar në fushën e arsimit dhe mësuesisë, duke nxjerrë breza të tërë nxënësish dhe duke përcuar kulturë në qytetin e Kavajës.
3. Dhënien e titullit "**Mirënjohje Qyteti**" Z. **Dëfrim Metolli** me motivacionin "Për kontributin e shquar në fushën e arsimit dhe mësuesisë, duke nxjerrë breza të tërë nxënësish dhe duke përcuar kulturë në qytetin e Kavajës.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Kulturës dhe Sporteve dhe Drejtoria Ligjore dhe e Shërbimeve Mbështetëse.
5. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga Prefektura Tiranë.

**SEK. KESHILLIT BASHKIAK**  
**Valbona MUSTAFA**

**KRYETARI I KESHILLIT BASHKIAK**  
**Aqif PEZA**



## R E L A C I O N

Drejtoria e Kulturës dhe e Sporteve, mbështetur në nenin 54, gërma "m" e ligit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe në Ligjin Nr. 112/2013 "Për Dekoratat, Titujt e Nderit, Medaljet dhe Titujt Vendorë të Nderit në Republikën e Shqipërisë", me propozim të Kryetarit të Bashkisë Kavajë, i kërkon Këshillit të Bashkisë Kavajë që në mbledhjen e tij të rradhës, të miratojë këtë projekt vendim si me poshtë vijon:

Në kuadër të Festës së "7 Marsit", Dita e Mësuesit, e cila shënohet si një ngjarje me rëndësi kulturore në gjitha trojet tona shqiptare.

Në këtë ditë ne të gjithë së bashku kujtojmë mësuesit tonë të parë që na mësuan shkronjat shqipe, na mësuan se si ta duam dhe ta respektojmë atdheun. Na mësuan poezitë e bukura të autorëve tanë të mrekullueshëm që çdo fjalë e varg i saj të mbetet e të ngulitet thellë në mendjet tona.

Me aq dashuri e respekt janë sjellur me ne për të na mësuar e kritikuar me atë metodën dashamirësisë kur ne bënim gabime. Mësimet e mësuesve tanë u bënë udhërrfyes përrugën tonë në të ardhmen. Ato mesime na ndjekin edhe sot që kemi dalë në jetën tonë të pavarur. Le t'ua dedikojmë suksesin tonë në jetë mësuesve tanë.

Për këtë arsy, kërkojmë të jepet titulli "**Mirënjojje Qyteti**" me motivacionin: *Në kuadër të festës se "7 Marsit" ditës ndërkombëtare të mësuesit. Per kontributin e dhene ne fushen e arsimit dhe mësuesisë, duke nxjerë breza të tërë nxënësish dhe duke përcuar kulturë në qytetin e Kavajës për:*

❖ **Pëllumb LUSHA** – I cili ka një karrierë të gjatë si mësues i "Ciklit të Ulët", ai ka dhënë mësimë në fshatin "Luz i Vogël" dhe një kontribut të madh në formimin e brezave ndër vite.

**"MIRËNJOJJE QYTETI"**

❖ **Halil KARIQI** – I cili ka një karrierë të gjatë si mësuës "Matematikë Fizikë" ka dhënë mësim në disa shkolla të qytetit si në: Shkollën "Rilindja" dhe në Shkollën e Mesme të Kavajës ka qenë Drejtues shkollë gjatë karrierës së tij të mësimdhënies.

**"MIRËNJOJJE QYTETI" (pas vdekjes)**

❖ **Dëfrim METOLLI** – I cili ka një karrierë të gjatë si mësues "Gjuhë Letërsie". Ai gjatë punës në arsim ka qenë mesues dhe drejtor shkolle, ka dhënë mësimë në fshatin "Mushnike" "Çetë" dhe "Helmas" dhe ka dhënë një kontribut të madh në formimin e brezave ndër vite.

**"MIRËNJOJJE QYTETI"**

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Kulturës dhe Sporteve.

**Duke ju falenderuar për mirëkuptimin.**

**Drejtori i Kultures dhe Sportit**

**Erjon LALAJ**

